

JUSUF BUXHOVI – HISTORIAN APO PROPAGANDIST SUBJEKTIV (?!)

Nga libri “enciklopedik” i Jusuf Buxhovit (në vazhdim akronimi JB), i quajtur “Kosova” (vëllimi 5), portali “botapress”¹ ka publikuar një fragment të gjatë, për t’i bërë reklamë librit, por edhe për vazhduar me manipulim të atyre që dëshirojnë të manipuloohen.

Për ata që nuk kanë informacion konkret, po ofroj një CV telegrafike: JB me profesion kryesor ishte gazetar, por ka shkruar shumë libra, të gjinive të ndryshme, deri edhe libretto për baletin “Halili dhe Hajria”. Është lindur në Pejë, në vitin 1946. Profesionalisht (me pagesë të rregullt), ishte i angazhuar në gazetën “Rilindja”, e cila ishte organ, fillimisht i Frontit Popullor të Kosovës (1945), pastaj i Lidhjes Socialiste të Popullit Punues të Kosovës. Aty e ka filluar punën në vitin 1967, për t’u atashuar pastaj si korrespondent në Gjermani, deri kur “Rilindja” nuk doli më (mbi tre dekada). Por, JB duhet të ketë qenë edhe ekzekutues i urdhrat për themelimin të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), më 23 dhjetor 1989. Ai e përzgjodhi Ibrahim Rugovën (IR) për kryetar të saj, i cili e komandoi LDK-në deri në vdekje (2006).

Edhe pse ka studiuar gjuhën dhe letërsinë shqipe në Prishtinë (1968), ai ka bërë magjistraturë në histori, po në Prishtinë (1979) dhe është marrë edhe me studime historike, në dukje si hobi, por ka rezultuar si veprimtari tepër voluminoze.

Në Gjermani kam pasur njohje me JB, qysh nga viti 1978, kur po ndodhte themelimi i Klubit Shqiptar në Dyseldorf; marrëdhëniet i kishim të natyrës diplomatike, siç thuhet për rastet kur nuk e ke as mik as koleg, por që komunikon dhe përplasesh herë pas here, në kuadër të taktizimeve të ndërsjella...

¹ http://botapress.info/jusuf-buxhovi-ushtria-clirimtare-e-kosoves-dhe-fark-u/#_ftnref19

Fragmenti që ka publikuar “Botapress” mban titullin “Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe FARK-u”. Nuk jam informuar nëse është titull i autorit JB, ose e ka vënë portali.

[1]

JB konstaton: *“Meqë rezistencës së armatosur i kishte munguar qasja aktive institucionale në rrethanat kur ajo ishte e pashmangshme, e të tilla ishin rrethanat pas Dejtonit, ndërkohë që faktorët tjerë jashtë saj, grupet e ndryshme guerile (të Dukagjinit, Drenicës dhe Llapit), të cilat edhe deri më atëherë kishin qenë të lidhur me segmentet vendore të shtetit paralel, do të përcaktohen për të, ishte e natyrshme që asaj t’i krijoheshin kornizat e një organizimi të përbashkët, që do të merrte përsipër ndërlidhjen e saj të brendshme dhe drejtimin.”*

Rëndom është një tekst-shkrues goxha i rrjedhshëm, për në këtë fjali të stërzgatur rezulton të jetë paksa i ngatërruar, ndoshta qëllimisht, që të mos shfaqet as mish as peshk, ose edhe mish, edhe peshk.

E para, ai shfaq mendimin së rezistenca e armatosur ishte e pashmangshme, sidomos pas Konferencës së Dejtonit (1996), por ajo nuk organizohej institucionalisht, në “shtetin paralel”, siç e quante JB Kosovën e viteve 1990-1999.

E dyta, “grupet e ndryshme guerile” i karakterizon si të ndryshme dhe jo-institucionaliste, por që, megjithatë, paskëshin pasur lidhje “me segmentet vendore të shtetit paralel”, që do të thotë se ato “grupe të ndryshme” paskëshin qenë të instruktura nga ato segmente.

E treta, paskësh qenë e natyrshme që “rezistencës së armatosur”, “t’i krijoheshin kornizat e një organizimi të përbashkët”, duke krijuar ndërlidhje dhe drejtim (udhëheqje).

Mua nuk me rezulton i saktë ky konstatim i ngatërruar, nga se grupet në Dukagjin, Drenicë e Llap, siç i lokalizon edhe JB, nuk ishin aq të ndryshme, por ishin të ngjashme dhe njëlojta, me të njëjtën platformë dhe me ndërlidhje të bashkëveprimtarisë në ato përmasa, sa të mos rrezikoheshin nga survejimi dhe përndjekja e strukturave policore serbe. Ato nuk kishin asnjë lidhje me “segmentet vendore të

shtetit paralel”, pavarësisht faktit se Adem Jashari dhe Zahir Pajaziti ishin të angazhuar edhe në parti “legale” (në fakt, ato ishin ilegale, meqë ato ishin të regjistruara në Baogradin pushtues dhe jo në Prishtinë), donjëherë u kishte rastisur të ishin pjesëmarrës edhe në fotografimet e rastit, grupe, që bëheshin për të pasur “dëshmi historike”, kur ndonjë lideruc kishte ndonjë aktivitet partiak. Përgjithësisht, nga viti 1990 deri në shpërthim të kryengritjes së armatosur çlirimtare (nuk ishte “rezistencë e armatosur”), në lëvizjen klandestine (e cila gabimisht quhet ilegale, vetëm pse nuk është regjistruar në Beograd), ka dominuar përcaktimi që një pjesë të veprimtarisë përgatitore çlirimtare ta kamuflonin si veprimtari “pacifiste” e “humanitare”, në kuadër të partive “legale”, të cilat i toleronte dhe i privilegjonte Beogradi pushtues. Kjo taktikë nuk mund të kualifikohet si lidhje e atyre grupeve me “segmentet vendore të shtetit paralel”.

[2]

JB: “Në këto rrethana, do të jetë ‘Lëvizja Popullore e Kosovës’ e drejtuar nga Zvicra dhe Gjermania, që do të veprojë konkretisht që Guerilja e Kosovës bashkë me forcat e tjera patriotike nga resurset e vetëmbrojtjes vendore si dhe potenciali i madh i ushtarakëve të Kosovës i shkapërderdhur jashtë ose i inkuadruar në luftëra të huaja në Kroaci dhe Bosnje dhe Hercegovinë, të përfshihen nën çatinë e përbashkët, që do të quhet ‘Ushtri Çlirimtare e Kosovës’.”

Se përse JB i fut në thonjëza Lëvizjen Popullore dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, nuk mund ta di saktësisht, por me këtë sikur dëshmohej se ai nuk është historian, por politikan subjektiv, për të mos thënë kuadër i luftës speciale, që rëndom e bëjnë shërbimet armiqësore edhe përmes kuadrove të sofistikuara, si JB. JB përdor emërtimin “Guerilja e Kosovës”, por kësaj radhe pa thonjëza dhe si të ishte emërtim i një formacioni konkret, duke anashkaluar saktësimet se në kohë e hapësirë të caktuar ajo guerile kishte formë dhe përmbajte të ndryshme. Qysh në vitin 1984, lëvizja klandestine, - e përfshirë kryesisht në Lëvizjen për Republikën e

Kosovës, e themeluar me 17 Janar 1998, - kishte bërë përpjekje për veprimtari guerile çlirimtare, dhe në krye të asaj përpjekjeje ishin martirizuar Rexhep Malaj, Nuhi Berisha, Afrim Zhitija, Fahri Fazlia dhe martirë të tjerë. Disa guerilës të kësaj lëvizjeje klandestine, në vitin 1991 mashtrohen nga truku komplotist që organizuan institucionet e “shtetit paralel” të Kosovës. Ata marrin pjesë në ushtrime ushtarake që i bëri Ushtria e Shqipërisë. Pothuajse pa i përfunduar ato ushtrime dy-mujore, institucionet e Serbisë i siguruan emrat e shumicës së pjesëmarrësve dhe numrin e armëve të tyre, dhe filluan përndjekjen e tyre. Në fakt, “shteti paralel” i Kosovës, i toleruar dhe i sponsorizuar nga Beogradi pushtues, ishte një mjet për të luftuar “pacifikisht” lëvizjen klandestine dhe guerilen e saj çlirimtare.

Me 26-27 korrik 1993 ajo frymë e gueriljes u konkretizua me vendimin që mori Kuvendi i Lëvizjes, - e cila aty e tutje u afirmua me akronimin LPK (Lëvizja Popullore e Kosovës) – për themelimin të forcës së armatosur çlirimtare, që më vonë, gjatë realizimit të atij vendimi, u emërtua Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK).

Meqë institucionet e “shtetit paralel” nuk e kishin përcaktim të tyre organizimin e veprimtarisë çlirimtare, - e si mund të merrej “shteti paralel”, i inskenuar nga Beogradi dhe i realizuar përmes krye-aktorëve si JB e IR, me organizim të gueriljes çlirimtare, - Lëvizja, pas pritjeve e përpjekjeve për të bashkë-organizuar lëvizjen e armatosur çlirimtare (jo rezistencën) me subjektet e atij “shteti paralel”, u detyrua të merrej me koordinim të grupeve dhe individëve, të përcaktuar për veprimtari të armatosur çlirimtare. Faza e pritjes ishte rezultat i shpresave dhe hutisë, se “alternativa kosovare”, respektivisht partitë “legale” dhe “shteti paralel” i tyre, ishin organizime patriotike, dhe jo truke të Beogradit për ta nënshtrur “pacifikisht” (paqësisht) popullin shqiptar të Kosovës.

Fatkeqësisht, edhe në këtë organizim të Lëvizjes, shërbimet armiqësore duhet të kenë penetruar spiunë dhe marioneta komplotiste, të cilët kishin për synim ta kapnin këtë organizim të ri,

UÇK-në, qysh në zanafillë. Megjithatë, Lëvizja ia doli t'i sfidonte, edhe pse pasojat ishin të mëdha!

Sipas JB, Lëvizja paskësh "shfrytëzuar hezitimin e politikës pa luftë dhe të luftës pa politikë, si dhe limitet e saj, së cilës i ishte nënshtruar lëvizja institucionale dhe njëherësh duke pasur parasysh potencialin e gueriljes së Republikës së Kosovës që vepronte nga viti 1991, por jashtë ndonjë mbikëqyrjeje të përhershme".

JB asnjëherë nuk do të lirohet nga ankthi i tij: "Lëvizja Popullore e Kosovës", e cila drejtohej jashtë vendit nga grupime të ndryshme militantësh majtistë, të njohur si enveristë". Ky gjitholog i suksesshëm asnjëherë nuk provoi të çlirohej nga ky ankth, as nga fakti që "militantët majtistë, të njohur si enveristë", qysh në mars 1981, të konfrontuar me zhvillimet në terren, ndryshuan përcaktim ideopolitik, duke hequr dorë nga përcaktimet e deriatëhershme për "revolucion proletar" dhe për çlirim kombëtar, për t'u mjaftuar me kërkesën Kosova-Republikë, në kuadër të Jugosllavisë federative. Ai e dinte fare mirë të vërtetën, se në Lëvizje mirëpriteshin edhe titistët shqipfolës, nëse ata ishin që Kosova të avanconte në Republikë. Këtë ofertë e mundësi e ka pasur edhe vetë JB, sepse sa herë ia kam prezantuar shkoqur përcaktimin programor të Lëvizjes. Por, meqë ai ishte i rreshtuar diku tjetër, dhe nuk ia mbante të dezertonte, ishte i detyruar të angazhohej meurvejim të veprimtarisë së Lëvizjes në emigracion dhe t'ua transportonte eprorëve të tij...

JB bën konkretizimin vijues: *"Midis viteve 1993-1996, pasi që shumë nga militantët e saj të jenë larguar nga Lëvizja Kombëtare që drejtonte LDK, LPK do të angazhohet me të madhe që të kthehet në 'krah lufte' të Gueriljes së Kosovës dhe pjesës tjetër të shkapërderdhur të rezistencës aktive, të cilës i mungonte mbi-këqyrja e duhur institucionale."*

Fakti se Beogradi neofashist, millosheviqian" e toleronte dhe e privilegjonte "Lëvizjen Kombëtare" që e "drejtonte" LDK-ja, është argument kokëfortë që ajo lëvizje vetëm kombëtare nuk ishte! Përndryshe, nuk mund të diskualifikohet pushteti i Millosheviqit si jo-

demokratik, nacional-shovinst, pushtues, neofashist, vrasës! Po Gjithologu JB dhe soji i tij, po vazhdojnë të imponojnë spekulimet e tyre mashtruese, që ta shijojnë sa të jenë gjallë kënaqësinë që po u krijojnë turma injorante, e cilat po vazhdojnë t'i madhërojnë si veprimtarë patriotë e çlirimtarë Jusufbuxhovët, edhe pse ishin marioneta e kuislingë të Beogradit, që simulonin “shtetin paralel”. Fatkeqësisht JB ende nuk është ndërgjegjësuar për të reflektuar, se meqë “institucionalistët” e “shtetit paralel” nuk donin të merreshin me organizim të gueriljes çlirimtare, - përkundrazi, eurvejonin dhe e spiunonin, - përse atëherë shfaqën kaq shumë mllef kundër këtij angazhimi të Lëvizjes! Sigurisht, ky qëndrim i tij mund të keqkuptohet, si mungesë e guximit për të dezertuar, meqë si intelektual, me kapacitete të mëdha që posedon, është në gjendje të kuptojë se ai angazhim i Lëvizjes rezultoi i suksesshëm në kuadër të kombinimit të veprimtarive të shumëllojshme çlirimtare.

Këtë lloj (dis)kualifikimi JB e përmbyll me konstatimin vijues: *“Edhe pse rrethanat nuk i kishte të përshtatshme dhe pa marrë parasysh gjuhën e ashpër dhe diskursit ideologjik kundër lëvizjes institucionale të drejtuar nga LDK, LPK ia doli që brenda faktorit luftë, të krijojë një pozicion koheziv e madje edhe drejtues me pretendimin që prej andej të dominohej edhe skena politike e Kosovës, që si parakusht kishte eliminimin prej saj të Lëvizjes Institucionale dhe shtetit paralel të Rugovës dhe ngrehinës së saj që për vite i kishin bërë rezistencë institucionale Serbisë thujse në të gjitha segmentet e jetës dhe si të tilla kishin gëzuar mbështetjen e pjesës më të madhe të qytetarëve të Kosovës.”*

Aspak e ndershme, edhe pse nga marioneta JB, konstatimi se Lëvizja kishte synim eliminimin “Lëvizjes Institucionale dhe shtetit paralel të Rugovës”. Kjo “lëvizje institucionale” dhe “shteti paralel”, të komanduara nga “paqësori” IR, e eliminuan veten e tyre, duke u pozicionuar gabimisht kundër kryengritjes së armatosur çlirimtare, e cila pati nismën në Epopenë e Jasharëve në Prekaz. Deri sa po merrte përmasa kryengritja, duke pasur shumë martirë, “paqësori” kuisling

komandoi mbajtjen e “zgjedhjeve të lira”, me 22 mars 1998, që synim kryesor kishin arsyetimin e sulmeve fashistoide të Beogradit pushtues millosheviqian, sikur ato ishin veprime legjitime në kuadër të ruajtjes së rendit publik në “shtetin paralel”.

[3]

Teksti në vazhdim mban nëntitullin: *“Marrëveshja Ramiz Alia Ibrahim Rugova për mbajtjen e ushtrimeve ushtarake në Shqipëri”*.

Ndonjëherë të dhimbset JB, që detyrohet të simulojë injorantin, sikur vërtetë kuislingu “pacifist” IR paskësh bërë marrëveshje me presidentin Ramiz Alia për ushtrime të mirëfillta ushtarake! Sikur dy, u thënçin presidentë, nuk kishin punë më me rëndësi, se sa të bënin marrëveshje për ato ushtrime aq ordinere, u thënçin ushtarake, respektivisht për një simulim që ishte menduar si taktikë për t’i identifikuar e pastaj për t’i “peshkuar” policia serbe guerilët.

Gjithashtu JB e ka ditur se koordinimet paraprahe për atë marrëveshje i kishte bërë “crni”, siç duhet ta ketë pasur nofkën UDB-ëske Dr. Ali Aliu, atëherë “ambasador” në Tiranë i “shtetit paralel” të Kosovës. Dhe them se JB duhet t’i ketë ditur, meqë atëherë ishte në krye të “institucioneve paralele”, si sekretar i LDK-së që ishte.

Konstatimi i radhës, spekulativ, i gjithologut Jusuf Buxhovi (JB): *“Por, lufta e LPK-së kundër shtetit paralel të Kosovës, nga zëdhënësit e saj që flisnin në emër të UÇK-së, nuk ishte gjithaq frontale siç pritej. Përqendrimi i tyre fokusohej te ‘fondet’ e luftës, duke kërkuar që edhe Trepërqindëshi i Qeverisë t’i takonte i tëri ‘autorëve të luftës’.”*

Interesant do të ishte hulumtimi, se si janë bashkërenditur angazhimet dhe prononcimet e kolegëve marioneta, që kolegut të tyre, marionetës JB, t’i bjerë tamam citimi i tyre në kuadër të misionit për të dezinformuar sa më shumë kundër Lëvizjes dhe UÇK-së. Ai, edhe pse shkruan “enciklopedi”, bën sikur nuk është me rëndësi t’u konkretizohen emrat atyre “zëdhënësve”. Pjesëtarët e Lëvizjes dhe të UÇK-së përherë e kanë demaskuar “alternativën kosovare”, partitë “legale”, “qeverinë Bukoshi”, “shtetin paralel”, si sabotues të Luftës

çlirimtare. Ndërsa marionetat komplotiste, që kamufloheshin me emblemë të UÇK-së, të cilët veten e emëronin edhe “kUmandanta” të UÇK-së, nuk ishin tjetër gjë pos kolegë të marionetave kuislinge, nga IB deri te JB; ndonjëri prej tyre mund që nuk e ka ditur se janë kolegë, meqë eprorët e tyre të përbashkët nuk i kanë dekonspiruar të gjithë emrat e kolegëve, në mënyrë që skenari “ajde da igramo drzavu” (eja të lozim shtetin), të dukej sa më autentik. Në rastin konkret, ishin Xhavit Haliti, Azem Syla, Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, që u thoshin, por jo vetëm u thoshin, “pronarëve” të tre-përqindshit, Bujar Bukoshit dhe Isa Mustafës, që t’ua jepnin ato mjete. Nuk di tjetër pjesëtar të Lëvizjes dhe të UÇK-së që të ketë bërë kërkesa e kërcënime të tilla.

Bujar Bukoshi, Isa Mustafa, Ahmet Krasniqi, por edhe JB, e dinin se Fondi “Vendlindja thërret” merrej me grumbullimin e ndihmave financiare për UÇK-në, por ata nuk i dorëzonin mjetet në këtë Fond, nga se ata qëllimisht i financonin marionetat komplotiste, Xhavitin, Azemin, Hashimin, Rexhepin, që ta sabotonin e komplotonin sa më harbutërisht UÇK-në dhe Luftën e saj çlirimtare.

Në dhjetor 1997 i patëm kërkuar takim BB, për ta lutur që të jepte ndihma për UÇK-në. Takimin ai na e caktoi në Aeroportin e Cyrihut, si gjoja vend më konspirativ. Ishim Jashar Salihu dhe unë. Jashari ia paraqiti gjendjen BB dhe e luti, por për ndihma modeste, meqë UÇK atëherë nuk kishte kapacitete logjistike për të shpenzuar miliona. BB në fund të bisedës bëri premtimin mashtrues: “Po ma dha lejen Prishtina, me kënaqësi do të ndihmoj.” (parafrazim). Ai, në fakt, nuk ia varte Prishtinës, por zbatonte komandën e eprorëve të tij. I njëjti BB, përmes Ahmet Krasniqit, u jepte ndihma më pas komplotistëve të UÇK-së, edhe pse që të dy e dinin se ndihmat për UÇK-në do të duhej t’i dorëzonin te Jashar Salihu.

[4]

JB broçkullis: *“Rezistenca institucionale, e vetëdijshme për zhvillimet që kishin ndodhur, në të cilat LPK, pa marrë parasysh mjetet që kishte përdorur në hapësirën e lënë, duke e përvetësuar atë pa kursyer mjetet, kishte dalë fituese, do të fillojë t’u përshtatet rrethanave me*

pretendimin që edhe faktori luftë të veprojë në gjirin e saj.”

Të vjen keq për kësi formulimi të ngatërruar. JB ka talent për të shkruar “shkurt e shqip”, por meqë e ka për mision të shtrembërojë rrjedhën e ngjarjeve, bën edhe formulime të ngatërruara. Ai sërish spekulon për “rezistencë institucionale”, si edhe për “shtetin paralel” dhe për “alternativën kosovare”.

Në një vend ku tolerohen rezistenca institucionale dhe shteti paralel, - bile edhe sponsorizohen e privilegjojnë, - ai vend nuk do të duhej të quhej i pushtuar. Ndërsa konstatimi së LPK paskësh dalë fituese “pa marrë parasysh mjetet që kishte përdorur”, është vetëm spekulim dezinformues. Lëvizja përherë bënte apel që të bashkoheshin të gjitha subjektet, grupet dhe individët, në luftë të përbashkët çlirimtare dhe ajo luftoi të institucionalizohej sa më shumë. Bile, edhe pse ishte mashtruar një herë në vitin 1992, për bashkim në fond të përbashkët për të grumbulluar ndihma, edhe në mars 1998, pasi kishte shpërthyer kryengritja e armatosur, Lëvizja bëri marrëveshje me “qeverinë Bukoshi” dhe me LDK e subjekte të tjera në emigracion, që bashkarisht të koordinonin grumbullimin e ndihmave në një fond të përbashkët dhe ato mjete të shpenzoheshin sipas nevojave të luftës çlirimtare. Por, pasi “kryeministri” Bukoshi prapë nuk dha ndihma, u detyrua ta zhbënte edhe atë marrëveshje. Për ato janë bërë njoftime publike, në kohë dhe hapësirë përkatëse, dhe, sigurisht, ato i ka ditur edhe i gjithë-informuari JB.

JB: “Kjo ‘kthesë’ për institucionistët nuk do të dukej gjithaq e vështirë kur dihej se në këtë punë nuk ishin as pa përvojë e as pa atu, ngaqë me vete kishin Gueriljen e Republikës së Kosovës nga viti 1991, së cilës ia kishin krijuar hapësirën për organizim dhe ushtrim në Shqipëri me anën e marrëveshjeve të vitit 1991 midis R. Alisë dhe I. Rugovës. Siç kishin edhe Ministrinë e Mbrotjtjes së Republikës së Kosovës, të krijuar në vitin 1992, e cila ishte marrë me çështjet e potencialit ushtarak të Kosovës të shpërndarë jashtë vendit, i cili ishte sistemuar ‘në pritje’.”

Kanë bërë ose nuk kanë bërë kthesë “institucionistët”, për këtë edhe vet JB simulon sikur nuk është i qartë, prandaj kthesën e thonjëzon Ndoshta edhe JB e di se nuk ishte fjala për kthesë, por për angazhime komplotiste të “institucionistëve”, kundër Luftës çlirimtare dhe bartësve të saj kryesorë. Ndërsa përvoja e vitit 1991 nuk ishte përvojë e sigurtë, autentike, por simulim, për të “peshkuar” policia serbe sa më shumë guerilë. Atëherë edhe nuk dihej tamam kush ishte ministër mbrojtjeje. Spekulohej të ishte Ramush Tahiri, që jetonte në Kroaci. Por flitej edhe për një ministër mbrojtjeje edhe në Kosovë. Këto simulime i ka rrëfye Nikë Gjeloshi, në maj të vitit 1995, kur pati dhënë dorëheqje nga përgjegjësia e “Ministrit të mbrojtjes”. Aty e tutje “shteti paralel” mbeti edhe pa “ministër” e “ministri të mbrojtjes”, qoftë edhe vetëm si simulim. Prandaj JB, siç e ka thonjëzuar “kthesën”, e ka thonjëzuar edhe “në pritje”, për të spekuluar se gjoja ishte sistemuar potenciali ushtarak, dhe ishte “në pritje” t’ia bënte bam, paçka se i shpërndarë jashtë vendit. Nga maji 1995 deri në mars 1998, kush qenkësh marrë me sistemim të potencialit ushtarak, kur tashmë nuk ekzistonte “ministri i mbrojtjes”?! Askush! Këto i di JB i gjithë-informuar, por nuk i konkretizon, meqë nuk do të demaskojë e diskreditojë “Rezistencën institucionale” dhe “institucionistët”, në krye të cilëve ishte edhe vet JB – si “themelues” i LDK-së dhe i “institucioneve paralele”.

[5]

JB: *“Duke u nisur nga obligimi kushtetues se ishte përgjegjëse për organizimin e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes, e me këtë edhe të rezistencës së armatosur, punë që asnjëherë nuk ishte çuar aty ku duhej, Qeverisa e Republikës së Kosovës, me ‘Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës FARK’, por nën emblemën e ‘Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës’, ishte shfaqur thujtëse ‘befas’ në skenën e rezistencës së armatosur.”*

Ky është dezinformimi i radhës që ka bërë gjithologu JB, përkundër faktit se krekoset të këtë shkruar enciklopedinë “Kosova” (në 5 vëllime). Por shtrohet pyetja, edhe pse ky gjitholog ka studiuar

gjuhën shqipe, a i përdor me vend thonjëzat?! Ta zëmë, në këtë rast emërtimin “Qeveria e Republikës së Kosovës” e përdor pa thonjëza, ndërsa FARK-un dhe UÇK-në i thonjëzon! E vetëm “qeveria Bukoshi” nuk ishte as simulim i hijshëm, e lere më qeveri.

Këtu JB ofron FARK-un si të mirëqenë, si kategori kushtetuese, pa ofruar asnjë informacion, kur dhe kush e formoi.

Për ata që nuk e dinë, po ofroj një informacion telegrafik për FARK-un, kur dhe kush e ka formuar. Më 3 mars 1998 (kur po ndodhte rrethimi i Jasharëve në Prekaz), Koloneli Ahmet Krasniqi organizon tubimin e 4-5 ish-ushtarakëve të APJ-së në Cyrih (akronimi shqip për ushtrinë jugo-sllave, e cila prezantohej me akronim JNA në serbisht, e shqipëruar: Ushtria Popullore Jugosllave). Aty formohet një ekip koordinues, i cili do ta vizitojë “kryeministrin” Bujar Bukoshi për të formuar ushtri. Kryesues i atij ekipi caktohet Ahmet Krasniqi. Ai, i shoqëruar me Agim Mehmetin, Shaban Shkrelin, Nebih Maxhunin, më 6 mars 1998 e vizitojnë “kryeministrin” BB në Weßenhorn (afër Ulm’it të Gjermanisë, ku BB duhet të ketë blerë një vilë me mjete të fondit të tre-përqindshit dhe ajo vilë nuk dihet se kujt i është “dhuruar”?!). Me atë rast ata ia paraqesin kërkesën BB me shkrim, “në emër të ushtarakëve” - për formim të Ministrisë së mbrojtjes dhe të FARK-ut. BB i miraton kërkesat e tyre dhe e emëron Ahmet Krasniqin Ministër të mbrojtjes dhe Komandant të FARK-ut. Kaq thjesht e kaq shpejt ka ndodhur formimi i ushtrisë, i njohur me akronimin FARK, dhe emërimi i Ahmet Krasniqit në ato dy funksione. Sigurisht, gjithëlogu JB e di se “kryeministri” BB nuk kishte kompetenca kushtetuese për të themeluar ushtri dhe për të emëruar komandantin e saj, prandaj nuk ofron asnjë të dhënë konkrete për FARK-un, por vetëm e faktorizon “heshturazi” si kategori të mirëqenë kushtetuese. E si usta i spekulimeve që është, JB përdor edhe konkretizimin “befas”, për daljen në skenë të kësaj ushtrie, që të arsyetohej se edhe “befas” ka (dez)informuar për FARK-un, nëse ndonjëherë do të akuzohej për dezinformim. Dhe vërtetë, “befas” pati dalë në skenë FARK-u, për të mos thënë “befas” ishte urdhëruar Ahmet Krasniqi që ta formonte atë strukturë diversioniste. Dhe po “befas” kanë vendos ta përdornin emblemën e UÇK-së, por si

kamuflim komplotist, pa e pyetur UÇK-në nëse ia lejonte atë (sh)përdorim.

Ndoshta (zh)vlerësimi i radhës që ka bërë gjithologu JB korrespondon me gjendjen. Citoj: “Ky fakt [formimi i FARK-ut – sqarimi im], prishi stereotipet e deritanishme të ndarjeve të brendshme në ‘paqësorë’ (institutacionistë) dhe ‘luftëtarë’ (çlirimtarë), paçka se amalgami ‘bashkim’, nxori ‘paralelizmin’ e luftës, si një gjendje konfrontuese, që në vend se t’i ndihmonte asaj, do t’i kthehet në pengesë me pasoja për luftën, por edhe pas saj. (...) Ndonëse Qeveria e Kosovës, para faktorit ndërkombëtar ishte munduar që ‘të fshihej’ prapa firmës së UÇK-së si veprim ‘paralel’ i atyre ‘që u kishte humbur durimi nga dhuna’, ndërkohë që nga brenda ishte munduar që në marrëveshje me gueriljen dhe faktorët që tashmë e lëviznin atë së paku politikisht – LPK-në, ta kthejë në pjesë të strukturave të saj dhe ta komandojë.”

Konstatimi i fundit, synimi që t’i komandonin edhe LPK-në (siç mashtronin se komandonin UÇK-në), ishte synim i përbashkët i atyre marionetave komplotiste që i “përfaqësonin” LPK-në dhe UÇK-në (kUmandantët e shtabit të Rognerit), dhe kolegëve të tyre, marionetave kuislinge Bujar Bukoshi e Ahmet Krasniqi. Fatmirësisht LPK dhe UÇK i sfiduan ato “palë” që bashkëpunonin e bashkëvepronin mes tyre, por me pasoja të mëdha!

Për ta madhëruar FARK-un si ushtri profesioniste, gjithologu JB (sh)përdor “betejën e Logjës” [si të kishte qenë e ngjashme me Betejën e Normandisë (4.06 – 25.08.1944)], sikur atë betejë e paskësh bërë FARK-u dhe jo UÇK-ja, siç kishte ndodhur me të vërtetë, ku u martirizua edhe komandanti i saj, Skënder Çeku, me 10 gusht 1998...

[6]

Nënkaptullin e radhës Jusuf Buxhove (JB) e ka quajtur “FARK-u në Dukagjin”, për të paralajmëruar një histori të bujshme të FARK-ut si një ushtri madheshtore çlirimtare. Për rast të ngjashme preshevarët

përdorin një proverb: “Mos u fry (krekos) për pushkë, kur nuk je as pushkallë!”

JB vazhdon me konstatimet e tij, që vetëm studimit historik nuk i kanë hije: *“Formacionet e FARK-ut, që u shfaqen në pjesën e Dukagjinit, në luftimet kryesore që do të zhvillohen gjatë verës së vitit 1998, ku më pakë e ku më shumë, këtë do ta bëjnë edhe në bashkëveprim me forcat ‘autentike’ të UÇK-së, të cilat LPK i kishte shpallur të pavarura nga ‘vija institucionale’ dhe bënte çmos që të mbeteshin të tilla pa marrë parasysh se kjo e dëmtonte rezistencën e armatosur. Madje, në Dukagjin, në kuadër të Zonës së Tretë Operative, kishin edhe strukturat e përbashkëta komanduese, siç ishte rasti me ato që komandonte Ramush Haradinaj.”*

Ndoshta diku tjetër JB ka ofruar informacion, kur dhe si “u shfaq” FARK-u në Dukagjin, por rendi dhe vendi i ka takuar të ketë pak informim konkret, qoftë edhe me data, kur e si është “shfaq” në Dukagjin dhe kur e si është “avulluar” që andej.

Siç ka rrëfyer vet Tahir Zemaj, komandant i brigadës 134, formimi dhe betimi i brigadës 134 ka ndodhur më 21 qershor, në prani të Ahmet Krasniqit. Në Kosovë ka hy në natën e 24 dhe 25 qershorit 1998, me gjithsej 150 ushtarë e personel komandues.² Por, në Jasiq, Shtabi i ZO të Dukagjinit ka urdhëruar që ata të mos vazhdonin rrugëtimin për në brendësi të Dukagjinit, por të ktheheshin prapa, në Shqipëri.³

Siç me ka rrëfyer kolonel Sali Veseli, atëherë shef operativ i Shtabit të UÇK-së për Dukagjin, anulimi i urdhrit që Tahir Zemaj me brigadë të të kthehej nga kishte ardhur, ishte bërë me ndërhyrje të Xhavit Halitit, i cili paskësh sqaruar Ramush Haradinajn, se ajo brigadë e FARK-ut ka hy në Kosovë me leje e në marrëveshje me “shtabin e përgjithshëm”, që në fakt duhet të ketë qenë “shtabi i rognërit”, të

² <http://www.trepca.net/2001/zemaj/zemaj10.htm>

³ <http://www.trepca.net/2001/zemaj/zemaj11.htm>

cilin e komandonte Xhavit Haliti.

Përmasat e subverzionit të brigadës 134 kulmon më 21 gusht 1998. Në mbledhjen e mbajtur në Prapaqan, komandantët e “vetëmbrojtjes popullore” e kanë zgjedhur Tahir Zemajn për komandant të “Shtabi Operativ i rrafshit të Dukagjinit”, ndërsa Ramushin për zëvendës-komandant, kryeshef Nazif Ramabaja, etj.⁴ Ky vendim do të shpallet ilegal në fund të gushtit 1998, me rastin e vizitës që i bënë kolonel Bislim Zyrapi, shef i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, duke e rikthye prapë Ramush Haradinajn për komandant dhe Tahir Zemaj për zëvendës.

Por, tashmë Zona e Dukagjinit përditë e më shumë po futej nën kontroll të forcave serbe, edhe për shkak të diversionit të komanduar nga Tahir Zemaj, nga 25 qershori 1998, kur ka hy në Kosovë, deri më 30 gusht 1998, kur është arratisur nga Kosova. Për këtë “shtabi suprem” i FARK-ut ka lëshuar kumtesë, ku pos tjerash, thuhej: “Tahir Zemaj nuk ka ikur, por është tërhequr me urdhër të Shtabit Suprem dhe të Qeverisë së republikës së Kosovës, pas situatës së krijuar. Kushdo që thotë të kundërt e kësaj të vërtete, ka si qëllim thjesht njëlloshjen e autoritetit dhe profesionalizimit të tij.”⁵ Vet nevoja për të lëshuar këtë kumtesë, është tregues se kerët e FARK-ut kuptuan që banorët e ndërgjegjshëm të Dukagjinit tashmë e gjykonin angazhimin e Tahir Zemajt për diversion ndaj UÇK-së në ZO të Dukagjinit.

Ramiz Muriqi me ka rrëfye se ka organizua dhe shoqërua kalimin e Tahir Zemajt nga Rugova, përmes Malit të Zi, të shoqëruar nga ministri i brendshëm i Malit të Zi.

Gjithologu JB dhe askush tjetër nuk mund të ofron provë konkrete që Lëvizja e ka shpallë ndonjëherë UÇK-në të pavarur nga “vija institucionale”, siç i quan ai strukturat institucionale të “shtetit paralel”. Një vendim i tillë nuk është marrë asnjëherë në asnjë organ udhëheqës të LPK-së!

⁴ <http://www.trepca.net/2001/zemaj/zemaj18.-formimi.htm>

⁵ „Kështu foli Tahir Zemaj”, f. 106; cituar sipas:

<http://www.trepca.net/2001/zemaj/zemaj22-terheqja-detyruar.htm>

Përse JB thonjëzon “vijën institucionale”?! Ndoshta e dinte se nuk kishte institucione, qoftë edhe virtuale, meqë në atë kohë “presidenti” ishte i “kidnapuar”, ndërsa “qeveria bukoshi” kishte vetëm tre persona: BB “kryeministër”, Isa Mustafën “ministër për financa” dhe Xhafer Shatrin “ministër për informim”.

Sa i përket “strukturave të përbashkëta komanduese” në Dukagjin, ofrova rrëfimin e vet kolonelit Tahir Zemaj, që të demitizohet edhe ky lloj miti që e kanë prodhuar JB dhe soji i tij.

JB (dez)informon: “Përplasje të brendshme [në mes të UÇK-së dhe FARK-ut – sqarim konkretizues imi] vazhdoi edhe gjatë operacioneve luftarake të NATO-s nga ajri nga 24 marsi deri më 10 qershor të vitit 1999 ndaj forcave ushtarake dhe policore serbe në Kosovë. Sado që në prill të vitit 1999, ishin pikërisht brigadat 123,131,134 nga radhët e FARK-ut që do të kenë rol të madh për shpërthimin e kufirit shqiptaro-shqiptar në Koshare dhe në pjesën e Pashtrikut.”

Përplasjet konkrete në mes të UÇK-së dhe FARK-ut janë manifestuar vetëm gjatë vere 1998, në Dukagjin, kur atje janë hy forcat diversioniste, të komanduar nga koloneli Tahir Zemaj. Ndërsa në Shqipëri kishin ndodhur ca zënka që ishin pjesë e simulimeve që duhet t’i kenë koordinuar mes tyre “shtabi i Rognerit” dhe “shtabi i Ahmet Krasniqit. Ky simulim duhej të kamuflonte bashkëpunimin në mes të atyre dy shtabeve, për ta komplotuar bashkarisht UÇK-në. Por edhe atij lloj simulimi i erdhi fundi me vrasjen e kolonel Ahmet Krasniqit, më 21 shtator 1998. Aty e tutje, pasi në vend të Ahmet Krasniqit erdhi Kolonel Halil Bicaç, edhe ai pak FARK që vepronte në terren, kryesisht në Shqipëri, u bë pjesë integrale e UÇK-së dhe prandaj edhe angazhimi disa ushtarakëve në “Betejën e Kosharës” (po e thonjëzoj për shkak të mitizimit të saj), ishte tashmë në kuadër të FARK-ut të UÇK-së, i cili zbatonte vendimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së dhe shefit të atij Shtabi, Kolonelit Bislim Zyrapi; kolegët dhe bashkëluftetarët e luftës për mbrojtje të Sarajevës, Kolonel Halil Bicaç dhe Kolonel Bislim Zyrapi ishin

autorizuar të koordinonin luftën, por fshehurazi, pa e marro vesh kUmandantët e “shtabit të Rognerit” dhe as “qeveria” e Bukoshit...

Siku JB të mos bazohej vetëm në “literaturë” të krahut “institucionalist”, të autorëve Agim Mehmeti, Tahir Zemaj, Shefqet Jashari, do të mund të ishte më i saktë, nëse do të konsultonte edhe rrëfime të “krahut luftarak”; në librin e Bedri Islamit, “Lëvizja – një lindje e përgjakur”, kam rrëfyer për zhvillimet që kanë ndodhur në kuadër të FARK-ut. Pas ardhjes së Kolonel Halil Bicajt për “ministër i mbrojtës” dhe komandant i Shtabit suprem të FARK-ut, më FARK-u nuk ishte “institucionalist”, gjegjësisht nuk ishte levë e “shtetit paralel” të Jusuf Buxhovit, Ibrahim Rugovës e Bujar Bukoshit! Edhe deri në vrasje të Ahmetit në strukturat komanduese të FARK-ut kishim të paktën 6 ushtarakë të UÇK-së, që do të përpiqeshin të pengonin veprimtarinë diversioniste e komplotistë të Ahmet Krasniqit, me bashkëveprimtarët e tij. Për këto veprime “subverzive” ndaj FARK-ut nuk dinin gjë kUmandantet e “shtabit të Ronerit”, ndërsa disa nuhatës të mprehtë të FARK-ut dyshonin se UÇK-ja kishte penetruar ushtarakë të saj në FARK. Ata ishin Xhafer Jashari, Fadil Demiri, Ramadan e Binak Gashi, Agim Haziri. Për ndonjë kolegë të tyre mund të informojnë vet këta ushtarakë “subverziv”.

[7]

Nënkaptullin pasues JB e ka titulluar: *“Plani i luftës i oficerëve Agim Mehmeti, kolonel Ahmet Krasniqi, Bajram Sylja dhe Shaban Shkreli.”*

“U dridh mali, polli një mi”, do të thoshin pleqtë e urtë për një kësi propagandimi kaq pompoz. Në fakt, bëhet fjalë për një tekst që duhet ta kishte për autor Ahmet Krasniqin, siç (dez)informojnë kolegët e tij. Dhe atë “plan” Ahmet Krasniqi duhet t’ua ketë dërguar Sali Berishës, Ibrahim Rugovës dhe Bujar Bukoshit, në janar 1997. Ai duhet ta ketë firmosur me pseudonimin “Fitim Shpata, nënkolonel”. E ka dërguar në emër të një “grupi të punës” (5 veta), të “Shoqatës së ushtarakëve të Kosovës”, bile edhe të “protokolluar”. Tepër interesante që Ahmeti në atë shkresurinë Kosovën duhet ta ketë

quajtur “Shqipëria veriore”, e cila nuk korrespondon me “vijën institucionaliste” as të Jusuf Buxhovit dhe as të Ibrahim Rugovës.⁶

JB (dez)informon: “Kështu, më 5 prill 1998, Qeveria e Kosovës, e ballafaquar me një realitet që nuk mund ta injoronte, emëron kolonel Ahmet Krasniqin Komandant të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës me mandatin për organizimin e strukturave ushtarake të domosdoshme për t’u përfshirë në vorbullën e luftës së cilës nuk mund t’i ikej. Që në fillim vërehet strategjia e pranimit të faktorit ‘Ushtri Çlirimtare e Kosovës’ dhe rolit të saj drejtues, me çka Qeveria hiqte dorë nga obligimi i saj kushtetues që të udhëhiqte luftën, por jo edhe nga përfshirja në të dhe drejtimi i saj nga brenda.”⁷

Aspak serioz vlerësimi që JB ia bën Bujar Bukoshit. E quan qeveri, - bile me germë të madhe, edhe pse është një pseudoqeveri, me trekatër veta, e një të ashtuquajtur “shtet paralel”; ajo “qeveri” nuk ngjante as në simulim virtual, përndryshe do të kishe ministra e ministri, do të dekretohej nga presidenti! Por kështu kategorizon JB, për shkak se vetë ishte njëri nga krye-marionetat që duhej të simulonte “ajde da igramo drzavu” (të bëjmë sikur po bëjmë shtet), për ta shtypur revoltën shqiptare në mënyrë “pacifiste”. Ndërsa emërimi i Ahmet Krasniqit me 5 prill 1998 nuk më rezulton informatë e saktë. Më 18 mars 1998, me ndërmjetësimin e këshilltarit të “Kryeministrit” BB, Z. Shemi Reçica, ndodh një takim i një grupimi të ushtarakëve, të dëshmuar në luftërat në Slloveni, Kroaci e Bosnje, me “kryeministrin” BB, në zyrën e “qeverisë” së Kosovës në Tiranë.

⁶ Faksimili „për një strategji aktive“, siç e ka titullin në origjinal, por që JB e quan „plani i luftës“, për hir të propagandimit sa më pompoz:

<https://telegafi.com/ahmet-krasniqi-ne-janar-1997-kerkonte-rezistence-me-lufte/>

⁷ Jusuf Buxhovi ka ofruar këtë shënim (fusnotë):

„Shih materialin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr. 5-4/2-98 me shifrën “tepër sekret”, në të cilin krahas emërimit të kolonel Ahmet Hajriz Krasniqit Komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës, me Urdhëresë 3/98 emëroi edhe eprorët e Shtabit të Përgjithshëm të FA të RK, në të cilin hynin: kapitenët e klasit të parë: Agim Ahmeti, Jahir Hyseni, Ismet Ibrahim, Enver Basholli dhe Ahmet Kukolaj si dhe togeri i aviacionit Shaban Shkreli dhe majori rezervë Selim Rrahmanaj.”

Aty ata oficerë shprehin kundërshtimin për t'iu subordinuar ushtarakisht Ahmet Krasniqit, për të cilin ata kishin dyshime se është marionetë e Ushtrisë së Serbisë. Aty “kryeministri” BB pati dezinformuar, se nuk mund ta ndryshonte emërimin e “pikës”, sepse e ka emëruar Prishtina. Kështu e quante BB në atë takim Ahmet Krasniqin dhe donte t'ua impononte ushtarakëve, sikur gjoja e kishte nominuar “presidenti” Rugova. Kështu mashtronte BB, i bindur se tashmë ai e kishte konsumuar autoritetin si kryeministër. [Edhe unë isha pjesëmarrës. / Për atë takim ka informuar konkretisht Shemsi Reçica para ca ditësh.]⁸

Formimi i FARK-ut dhe nominimi i Ahmet Krasniqit nga “kryeministri” BB duhet të ketë ndodhur me 7 mars 1998, kur Ahmet Krasniqi me ushtarakët e përmendur më lartë vizitojnë BB në vilën e tij në Weißentorn të Gjermanisë. Këtë e rrëfen edhe Agim Ahmeti, zëvendësministër i Ahmet Krasniqit.⁹

Gjithologu JB ka vështirësi të thotë të vërtetën, se “qeveria” e BB nuk ishte e përcaktuar për të zbatuar obligimin kushtetues, por vetëm që ta komplotonte UÇK-në dhe luftën e saj çlirimtare. Prandaj e ka torturuar veten e tij, si të përshtasë formulime që duhet të kamuflojnë përcaktimin komplotist të udhëheqësve të institucioneve kryesore të “shtetit paralel”, dhe të mos hetohet se po bënte këtë subversion edhe përmes kësaj “enciklopedie” ndaj zhvillimeve të vërteta.

JB: “Ishte ky një qëndrim taktik [i “qeverisë”], me të cilin ‘politika pa luftë’, kërkonte që ta rikthente ‘kapitalin’ e Gueriljes së Republikës së Kosovës nga viti 1991-1993 dhe resurset e saj të njohura të shtrira në vend përherë të gatshme për veprim, të lënë pa mbikëqyrjen e duhur.”

Sa serioz mund të jetë një studiues që bën kesi spekulimesh?! Që do të thotë, “qeveria” e BB nuk e kishte sinçerisht organizimin e luftës çlirimtare, por “ishte ky një qëndrim taktik” i saj. Dhe pastaj

⁸ <http://pashtriku.org/?kat=43&shkrimi=7828>

⁹ <https://www.youtube.com/watch?v=I7g4wUkelUI>

dezinformon, sikur paskësh pasur një guerilje “institucionaliste” të Kosovës, - guerilje me gurmë të madhe, - gjatë viteve 1991-1993, kur ende vetë Jusuf Buxhovi ishte bos i LDK-së, gjegjësisht bos edhe i “qeverisë”, meqë LDK-ja ushtronte atëherë pushtet virtual monist. Por, ja që ajo guerilje (inekzistente), “përherë e gatshme për veprim”, pas vitit 1993 na qenkësh lënë “pa mbikëqyrjen e duhur” nga institucionet fiktive të “shtetit paralel”.

JB: *“Koloneli [Ahmet Krasniqi], i cili e dinte veprimtarinë e mirëfilltë të Gueriljes së Republikës së Kosovës të drejtuar nga A. Jashari, Z. Pajaziti dhe S. Çejku, si dhe rolin e tyre të madh që ajo të mbahej e gjallë përkundër rrethanave tepër të vështira, si dhe gjendjen në të cilën ndodhej pas vrasjes së Z. Pajazitit para një viti dhe veçmas të A. Jasharit së voni, kur ajo tashmë e tëra ndodhej nën mbikëqyrjen politike të LPK-së, do të thotë se UÇK ‘ka nevojë të madhe për ne. Do ta ndihmojmë atë që të rritet dhe profesionalizohet’. Me këtë rast ai nuk do të harrojë ta nxjerrë në pah edhe kredon e luftës ku kyçja në të nënkuptonte edhe marrjen e komandës, që duhej të vërehej shumë shpejt në terren.”*¹⁰

Ky ishte synimi: marrja e komandës ndaj UÇK-së nga marioneta Ahmet Krasniqi, e përkrahur institucionalisht dhe financiarisht nga kuislingu Bujar Bukoshi.

[8]

Nënkaptullin e radhës Jusuf Buxhovi (JB) e ka titulluar: *“Takimet e Ahmet Krasniqit me Xhavit Halitin e Bardhyl Mahmutin”*. Dhe e ka nisur nënkaptullin me fjalinë: *“Takime të njëjta kolonel Ahmet Krasniqi pati edhe me përfaqësuesit e UÇK-së në Zvicër, zëdhënësin diplomatik të saj, Bardhyl Mahmutin, si dhe Xhavit Halitin, Shaban Mujën dhe Bilall Sherifin, me të cilët u takua dy herë: nga mesi i*

¹⁰ Po aty.

marsit dhe një muaj më vonë, ku hetohej gatishmëri për bashkëpunim dhe luftë të përbashkët.”¹¹

Ky nëntitull duhet të ketë synuar paralajmërimin e takimeve në mes njerëzve kompetentë, legjitimë, institucionalistë. Takime?! Ta zëmë, duhet të jetë fjala për një takim rastësor gjatë një ceremonie mortore për motrën, që ka organizuar Hilmi Nebihu, atëherë me banim në Bex të Zvicrës, ku banonte edhe Bardhyl Mahmuti. Po në atë ceremoni (që rëndom quhet “tpame”, gjegjësisht vizita për të shprehur ngushëllime), ka shkuar edhe Ahmet Krasniqi. Dhe meqë aty janë njohur me Bardhylin, Ahmeti ka shkruar një letër, përmes të cilës ka shprehur gatishmërinë për të bashkëpunuar dhe për ta përkrahur financiarisht UÇK-në. Atë letër Bardhyli ia ka përcjellë Xhavit Halitit.

Shyqyr që Jusuf Buxhovi nuk i ka dëgjuar edhe rrëfimet e para-caditshme të Idriz Mehmetit! Përndryshe edhe ato do t’i përdorte si burim për të pasuruar takimet e Ahmetit edhe me Hashim Thaçin. Bëhet fjalë për telefonatën, që duhet t’ia ketë bërë Ahmet Krasniqi në fund të marsit 1998 Idrizit, për njohje mes tyre. Dhe pasi duhet të jenë takuar në Cyrih, Idrizi i ka ofruar Ahmetit mundësinë për takime me “shefa” të UÇK-së. Pas ca ditësh Idrizi duhet ta ketë takuar Hashimin dhe e ka bindur të takohej me Ahmetin. Hashimi ka pranuar. Qenkëshin takuar, po në Cyrih, në banesë private, në zilen e derës së të cilës ka qenë emri i Ahmet Krasniqit.¹²

Gjithandej i sapo-emëruari “Ministër i mbrojtjes”, Ahmet Krasniqi, me takime me “shefa” të UÇK-së, edhe rastësore, si ai me Bardhyl Mahmutin në Bex, por që paskësh hyrë në “histori” përmes “enciklopedisë” së JB.

Përse interesimi i Ahmetit për gjithë ato takime? Përse i duheshin ato takimet tjera, pasi kishte ndodhur “takimi” në mes të muajit mars 1998, në Bex, me Bardhyl Mahmutin? Mos ndoshta të fuste sa më shumë pyka, se njëra do të çante...?!

¹¹ JB e jep si burim: Mehmeti, Agim: “E vërteta për FARK-un”, Prishtinë 2014, faqe 82.

¹²

<https://www.facebook.com/llapashtica1998/videos/1880026422017791/UzpfSTczNDM4Mzg2NzoxMDE1ODAsODIzNTg1ODg2OA/>

JB: *“Xhavit Haliti kishte premtuar se do ta shtronte çështjen e bashkimit të UÇK-së e të Ministrisë së Mbrojtjes në ndërtim me personat që janë në krye të Shtabit të UÇK-së.”*¹³

Aspak serioze! JB, pas kaq shumë vitesh, ka pasur kohë e mundësi të verifikojë (dez)informatat e Agim Mehmetit e Shefqet Jasharit, e të mos e degjenerojë “enciklopedinë” e tij në thash-e-themnajë!

Në vazhdim JB broçkullis: *“I. (Ismet) Abdullahu [Ahmet Krasniqit] ia kishte përcjellë porosinë e Ilir Konushevcit ‘se njësitë guerile të Llapit e shihnin të domosdoshëm formimin e një subjekti ushtarak të përbashkët me një komandant të përbashkët’, dhe se ‘angazhimin e Ahmet Krasniqit rreth bashkimit të faktorit ushtarak shqiptar e përkrahte pasi që e vlerëson si shumë të qëlluar’.”*¹⁴

Përse duhej t’ia thoshte Ismet Abdullahu ato gjepura Ahmet Krasniqit, kur Ilir Konushevcit ishte në Tiranë dhe mund ta takonte sa herë të donte Ahmet Krasniqin dhe t’ia thoshte vetë? Pastaj, Iliri nuk mund të fliste në mars 1998 për “njësitë guerile të Llapit”, kur ai e dinte veten si anëtar të Shtabit të UÇK-së dhe ai në atë kohë e udhëhiqte logjistikën e UÇK-së në Shqipëri. JB nuk mund të arsyetohet se ka përdorur si burim librin e Agim Mehmetit, meqë historiani i dinjitetshëm i seleksionon seriozisht burimet. Këtë e di JB, por ai i (sh)përdor qëllimisht këto burime, për qëllime dezinformuese e propaganduese, dhe po u hetua, të arsyetohet se ka përdorur librat e Agim Mehmetit dhe Shefqet Jasharit! Titist tipik!

JB (dez)informon në vazhdim: *“Grupi i ushtarakëve në Dyseldorf, ndër të cilët F. Ladrovci, Xh. Jashari e të tjerë, pas mbledhjes së mbajtur më 3 maj, iu kishin drejtuar Qeverisë së Republikës së Kosovës me këto kërkesa:*

¹³ Tashmë JB e (sh)përdor si burim, kë tjetër pos: Jashari, Shefqet-Strofcit: “Pse jemi kështu siç jemi”, Prishtinë 2002, faqe 176-180.

¹⁴ Kësaj radhe JB e (sh)përdor si burim “historik”: Mehmeti, Agim: “E vërteta për FARK-un”, Prishtinë 2014, faqe 82.

– të rishqyrtojë vendimin e vet në lidhje me emërimin e Ministrit të mbrojtjes,
– të pranohet UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) si bërthamë e Forcave të Armatosura të Kosovës (FAK) dhe
– mjetet e grumbulluara financiare nga populli të përdoren për qëllimet e dedikuara në çlirimin e atdheut.
Ushtarakët e Dyseldorfit plotësimin e kërkesës së tyre e lidhnin kohësisht me datën 16 maj. Mosplotësimi i saj, si thuhet, i detyronte që luftën ta bënin jashtë ‘institucioneve qeveritare’.¹⁵
Mjafton fakti se Fehmi Lladrovci kishte hyrë në Kosovë më 17 mars 1998 dhe atje ka qëndruar deri sa është martirizuar(22.09.1998), prandaj nuk ka mundur të ishte pjesëtar i “Grupit të ushtarakëve në Dyseldorf” në mbledhje më 3 maj 1998!

Qëllimin e (sh)përdorimit të asaj farë letre JB e zbulon vet me konstatimin e tij: “Letra e ushtarakëve të Dyseldorfit, shumë prej të cilëve prej kohësh nën mbikëqyrjen politike të ‘Lëvizjes Popullore të Kosovës’, e njohur për qëndrimin e saj radikal kundër lëvizjes institucionale dhe ‘Lidhjes Demokratike të Kosovës’ si bartëse e saj, paralajmëronte mospajtimin dhe kahet e kundërta të asaj, që do të kthehet në ‘luftë paralele’, në dëm të luftës së përbashkët.”
Ky farë pseudohistoriani ndonjëherë ta shpif në ato përmasa, sa ta injorosh për fare! Prandaj kësaj radhe nuk po ia komentoj këtë opinion kaq të shpifur.

JB: “Në përputhje me këtë disponim të shumë grupeve guerile që vepronin në Kosovë, nga 23-25 maj 1998, në Oslo të Norvegjisë, do të organizohet edhe takimi i Ahmet Krasniqit me Adem Demaçin, i cili kishte marrë përsipër detyrën e zëdhënësit politik të UÇK-së. Për këtë takim ishin të interesuar të dy palët. (...) kolonel Ahmet Krasniqi në emër të Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës dhe Adem Demaçi në emër të ‘Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës’, ishin pajtuar për

¹⁵ Shih faksimilen e letrës së Grupit të ushtarakëve të Dyseldorfit te Mehmeti, Agim: “E vërteta për FARK-un”, Prishtinë 2014, faqe 204.

*një bashkim ushtarak të të gjitha forcave patriotike nga ato institucionale dhe të grupeve guerile që shfaqeshin si 'Ushtri Çlirimtare e Kosovës', shumica e të cilave praktikisht ndodheshin nën drejtimin e 'Lëvizjes Popullore të Kosovës'."*¹⁶

(Sh)përdorimi i thonjzave nga JB po ma krijon dyshimin, mos ndoshta portali ia ka ndryshuar tekstin origjinal, meqë vetë JB ka nivel profesional gjuhësor, për të ditur kur dhe si përdoren! Përse i duhet JB të ndërlihdë takimin në Oslo me disponim të "grupeve guerile", kur në të njëjtën fjali i përmend si "palë" Adem Demaçin, si "zëdhënës" i UÇK-së (në fakt ishte prezantuar përfaqësues politik)?! I ka hije një historiani, me pretendime për të qenë edhe akademik, ta marrë seriozisht takimin në Oslo, kur edhe ai vetë e di se asnjëra "palë" nuk ka qenë e ngarkuar nga askush për të marrë pjesë në një takim të tillë, e aq më pak për të vendosur për çfarëdo bashkimi ushtarak?! Nuk i ka, edhe pse i thonë JB! Megjithatë, krekoset, dhe propagandon, të ketë shkruar historinë enciklopedike për Kosovën! Në fakt, ka shkruar një pamflet propagandist, për të kamufluar e arsyetuar angazhimet marionetiste e komplotiste të tij me bashkëveprimtarë!
Fatkeqësisht!

[9]

Nënkapitullin e radhës Jusuf Buxhovi e ka quajtur: *"Përmbajtja e Marrëveshjes së Oslos."*

Truk i zgjuar i një propagandisti të rryer! JB e ka potencuar "përmbajtja", që lexuesi të besojë se marrëveshja ishte miratuar, por tashmë po ia bënte asaj shqyrtimin "enciklopedik"! Këtij studiuesi, që ka (sh)përdorur profesionalizmin e tij për interesa politike subjektive, nuk i ka interesuar të merret me hulumtimin se i cilit nivel ishte

¹⁶ Në takimin e Oslos nga 23-25 maj 1998 midis kolonel Ahmet Krasniqit dhe Adem Demaçit kishte marrë pjesë, në anën e delegacionit të Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës edhe ushtaraku Agim Mehmeti, ndërsa në anën e Demaçit, përfaqësuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës: Xhavit Haliti dhe Shaban Muja. Ky i fundit ishte në lidhje familjare me kolonel Ahmet Krasniqin (dajë-nip), gjë që do të marrë përsipër strehimin dhe sigurimin e kolonelit gjatë qëndrimit në Tiranë.

takimi në Oslo, kush merrte pjesë, në çfarë cilësie, kush i kishte autorizuar “palët”, kë kishin konsultuar paraprakisht, etj.

JB (dez)informon: *“Edhe pse përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, për arsye ‘strategjike’ nuk ishte botuar, bazuar në bllokun e shënimeve të kolonel Ahmet Krasniqit, po edhe nga burime të tjera të pavarura dhe disa ‘të tërthorta’ nga UÇK, ajo përfshinte këto pika:*

- 1). *Dy subjektet ushtarake, UÇK-ja dhe Ministria e Mbrojtjes, bashkohen në një subjekt të përbashkët ushtarak, i cili do të quhet: ‘Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës’ (FARK).*
- 2) *Marrëveshja i njeh formacionet ushtarake që vepronin në Kosovë bashkë me komandantët e tyre si dhe me emrin me të cilin qenë zyrtarizuar në opinionin publik.*
- 3) *Subjektin e përbashkët ushtarak „Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës” do ta përbëjnë këto njësi:*
 - a) *Njësitë operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK)*
 - b) *Njësitë e Mbrojtjes Territoriale.*
 - c) *Njësitë e Aviacioni Luftarak.*
 - ç) *Njësitë e Ministrisë së Brendshme.*

(Ky subjekt ushtarak do të udhëhiqet nga Shtabi i Përgjithshëm i përbërë nga përfaqësuesit e subjekteve ushtarake që janë bashkuar në FARK. Një pjesë e këtij Shtabi do të vepronte në Shqipëri dhe pjesa tjetër në Kosovë).
- 5) *Njësitë ekzistuese që vepronin në Kosovë do të riorganizohen dhe do të forcohen me kuadro ushtarake profesionale, me qëllim të funksionimit të komandës hierarkike dhe të disiplinës ushtarake moderne.*
- 6). *Kuadri i deritashëm udhëheqës i njërive të UÇK-së do të gradohet me grada ushtarake sipas kriterëve të përgjithshme ushtarake dhe propozimeve konkrete në çdo njësi ushtarake veç e veç.*
- 7). *Ndalohej politizimi i ushtrisë.*
- 8). *Komunikatat e UÇK-së nuk do të dalin në opinion pa u korrigjuar nga Komandanti i SHP të FARK-ut, kolonel Ahmet Krasniqi.*

9). *Opiniononi nuk do të njoftohet për bashkimin e dy subjekteve ushtarake, Ministrisë së Mbrojtjes dhe UÇK-së në FARK, për shkaqe strategjike dhe diplomatike, përderisa ushtria të forcohet në atë nivel që të ishte në gjendje të kryente aksione operative, që do ta ngritnin nivelin e luftimeve nga mbrojtja në mësymje, nga lufta guerile në luftë frontale.*

10). *Do të funksiononin dy fondet ekzistuese, Fondi i Qeverisë së Kosovës dhe Fondi Vendlindja Thërret.*

11) *Të gjitha mjetet e grumbulluara në dy fondet ekzistuese do të përdoren për forcimin dhe modernizimin e njësisve çlirimtare të FARK-ut.*

12). *Adem Demaçi mori për detyrë që të konsultohet dhe t'ia afronte detyrën e Komandantit të Njësisve të Mbrojtjes Territoriale të Kosovës ushtarakut madhor Ramadan Qehaja, dhe po që se ai e pranon detyrën, Demaçi do ta lajmëronte Ahmet Krasniqin.*¹⁷

Spekulative: edhe pse teksti i ndonjë marrëveshje të mundshme nuk është publikuar, për shkaqe strategjike, siç falsifikon JB, megjithatë ky gjitholog merr guximin të ofrojë përmbajtjen, por duke e sajuar në bazë të “shënimeve” të kolonel Ahmet Krasniqit, por edhe duke simuluar të bazuarit në “burime të tjera të pavarura dhe disa ‘të tërthorta’ nga UÇK”.

Në nënkapitullin pararendës JB pati ofruar emrat e pjesëmarrësve në takim të Oslos, në fusnotë, ku rezultonte se Ahmet Krasniqi dhe Adem Demaçi kishin kryesuar “palët”. Por as në atë nënkapitull, as në këtë, nuk ka ofruar asnjë të dhënë, kush i kishte caktuar dhe autorizuar këta dy persona të përfaqësonin – Ahmet Krasniqi ministrinë inekzistente të mbrojtjes dhe FARK-un ndoshta të sapoformuar, ndërsa Adem Demaçi UÇK-në, në konsolidim e sipër (meqë jemi në muajin maj 1998)!

Se cilët qenkëshin burimet tjera “të pavarura dhe disa ‘të tërthorta’

¹⁷ Mehmeti, Agim: “E vërteta për FARK-un”, Prishtinë 2014, faqe 107-112; Jashari, Shefqet-Stroviç “Pse jemi kështu siç jemi”, Prishtinë 2002, faqe 180-183.

nga UÇK”, JB nuk ka ofruar asnjë informim konkret, nëse abstrahohen burimet e varura nga blloku i shënimeve të kolonel Ahmet Krasniqit dhe në dy librat e dy propagandistëve të zellshëm të LDK-së dhe FARK-ut: Shefqet Jasharit-Strofcit dhe Agim Mehmetit. Pra, kësaj radhe i ka mjaftuar truku sugjestionues, se vërtet është bazuar edhe në burime të pavarura (të “krahut” të LDK-së dhe “qeverisë”) dhe “të tërthorta” të UÇK-së (meqë të UÇK-së i diskualifikon si të tërthorta).

Të gjitha këto “fizkultura” do të ishin të panevojshme, sikur “palët” të kishin bërë marrëveshje dhe secila të kishin nga një origjinal të firmosur nga kryesuesit e palëve! Përse nuk e kanë?! Sepse nuk ekziston! Të paktën jo, në kuptimin që i takon një marrëveshjeje të këtij niveli.

Në pikën e parë të “marrëveshjes”, - të cilën JB e ka shënuar me germë të madhe, pa thonjëza, - qëndron, hiç më pak se sa vendimi “historik”:

“Dy subjektet ushtarake, UÇK-ja dhe Ministria e Mbrojtjes, bashkohen në një subjekt të përbashkët ushtarak, i cili do të quhet: ‘Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës’(FARK).”

Ndoshta gjithlogut JB pa dashje i kanë shpëtuar dy gabime “teknike”, meqë nuk ngjan të jetë e logjikshme: I pari, “subjektet ushtarake” UÇK dhe ministria e mbrojtjes të bashkohen në një subjekt të përbashkët, i cili do të quhet FARK, i dyti, sikur nuk paskësh pasur deri më 22 maj 1998 FARK, por u formua këtu nga bashkimi i “dy subjekteve ushtarake”?!

Meqë një marrëveshje e tillë konkrete nuk ekziston, nuk ia vlen të komentohen 12 “pikat” dhe 4 “nënpikat” e pikës 3. Mjafton që e ofrova gjithë tekstin (e JB), për ata që do ta lexojnë këtë reagim, të kenë informacion sa më të kompletuar, se si kanë ndodhur komplotet kundër UÇK-së dhe Luftës së saj çlirimtare, në fazën më delikate të konsolidimit të saj.

Nuk do mend të thuhet, se nga “krahu institucional” nuk duhet të jenë pyetur fare “presidenti” IR dhe “kryeministri” BB, ndërsa nga “krahu” i UÇK-së, në ato rrethana (maj 1998), nuk kishim funksionalitet organizativ të atij niveli, sa të autorizonim dikë që ta përfaqësonte me kompetenca deri edhe në “bashkim” të saj në një ushtri të re. Në atë kohë Xhavit Haliti ishte ende vetëm anëtar i Komisionit të rëndësisë së veçantë, që e kishte themeluar Këshilli i Përgjithshëm i LPK-së (në dhjetor 1993), ndërsa Adem Demaçi nuk ishte as pjesëtar i UÇK-së; tek me 12 gusht 1998, kUmandantët (inekzistentë) Xhavit Haliti, Azem Syla dhe Hashim Thaçi, kanë simuluar sikur e kanë caktuar AD për përfaqësues politik të UÇK-së, ndërsa takimi në Oslo ndodhi me 22 maj 1998. Pra, AD dhe Shaban Muja, si pjesëtarë të “palës” së UÇK-së, ishin (sh)përdorur dhe instrumentalizuar nga Xhavit Haliti, sepse deri atëherë ata të dy nuk kishin asnjë funksion në UÇK! Dhe nuk ka qenë hera e parë që Xhavit Haliti e ka (sh)përdorur AD; sa herë që i duhej për të përforcuar pozitat e veta të lëkundura në LPK, e ka (sh)përdoruar, ndërsa kësaj radhe po e (sh)përdorte për ta përforcuar kapjen e UÇK-së, që ta komplotonte më pasoja sa më të mëdha! Fatkeqësisht! Përse AD e pranonte këtë lloj instrumentalizimi e (sh)përdorimi nga marioneta Xhavit Haliti, kjo mbetet për t’u hulumtuar, por konstruktive dhe fisnike nuk ishte aspak. Ndoshta AD do të mund të arsyetohet se nuk kishte informim dhe prandaj, me mendimin se po i shërbente kauzës kombëtare, pavetëdijshëm ka lejuar të (sh)përdorej e instrumentalizohej kaq vulgarisht edhe nga Xhavit Haliti.

Uroj të mos ketë pas eprorë nën hije (kuadro të Beogradit), që i kanë inskenuar dhe komanduar këto komplete kaq goditëse!

AD disa herë ka bërë ca demantime ndaj spekulimeve për “marrëveshje të Oslos”, por ato ishin me la m... me sh..., siç shprehej shpesh vet AD për raste të ngjashme. E dinjitetshme ka qenë të reflektonte, se është (sh)përdorur e instrumentalizuar, më 22 maj, por edhe me 12 gusht 1998!

Ndërsa Shaban Muja (“Magjupi”) ishte i informuar për gjendjen reale në UÇK dhe LPK, dhe nuk mund të arsyetohet!

Kryesia e LPK-së nuk është konsultuar, bile as nuk është informuar, për atë “takim” në Oslo, i cili, falë UÇK-së së Vegjëlisë çlirimtare të Kosovës dhe fatit, nuk i pati pasojat që ia kishin kurdisur ato dy “palë” në Oslo!

Fatmir Zymeri, nikoqiri i takimit (meqë në zyrë të firmës se tij në Oslo ka ndodhur takimi), ishte përkujdesur për inçizim audio të takimit. Nëse ka qenë inçizim i miratuar paraprakisht nga “palët”, atëherë nuk ka kuptim që inçizimin ta ketë vetëm njëra “palë”, kurse tjetra të mjaftohet vetëm me këto shënime në blloqe personale, që tashmë i ka (sh)përdorur edhe JB, duke i kualifikuar si burime të pavarura, autentike, historike.

Edhe nëse është ruajtur inçizimi audio, duhet çmuar si provë për të ilustruar komplotin e ndodhur, por jo edhe si provë e një marrëveshjeje legale, meqë asnjëra “palë” nuk ka qenë e autorizuar për përfaqësim me kompetenca edhe të tjetërsimit të “dy subjekteve ushtarake”, UÇK-së dhe “ministrisë së mbrojtjes”, duke i “bashkuar” në ushtri të re, të quajtur FARK!

[10]

Në vazhdim JB (dez)informon: “Marrëveshja e Oslos ishte një arsye e mirë që të fillohet me zotimet e dala nga kjo. Kolonel Ahmet Krasniqit, të cilit i binte barra më e madhe e punës, urdhëroi për formimin e formacioneve materiale-teknike nga niveli i skuadrës e deri në nivel të brigadës. Organizimi i formacioneve kërkonte edhe hapjen e qendrave stërvitore në Shqipëri, të cilat u vendosën në Viçidol dhe në Papaj në Tropojë, në afërsi të kufirit me Kosovën. Jahir Zeneli caktohet komandant i Qendrës për Rekrutim, Stërvitje dhe Përgatitjen e Kuadrit Ushtarak, ndërsa Brahim Ukëhagaj caktohet zëvendës komandant për logjistikë.”¹⁸

¹⁸ Mehmeti, Agim: “E vërteta për FARK-un”, Prishtinë 2014, faqe 107-112; Jashari, Shefqet-Strovc “Pse jemi kështu siç jemi”, Prishtinë 2002, faqe 122.

Në pjesën pararendëse kontestova “marrëveshjen e Oslos”, në frymë e përmbajtje, siç e ka prezantuar e komentuar JB, duke pasur për bazë edhe reagimet e pjesëtarëve të njëjës “palë”: AD dhe Xhavit Halitit. Por, ndodhja e atij “takimi” nuk mund të kontestohet. Fatkeqësisht, ende nuk kemi të dhëna të bollshme se kush e ka urdhëruar e koordinuar. Por, që nuk janë takuar për një qëllim të caktuar, nuk është logjike të thuhet. Unë vazhdoj të dyshoj se janë takuar për të koordinuar, me forca të përbashkëta, - jo si dy palë, por si “palë e vetme”, - kompletet kundër UÇK-së dhe Luftës së saj çlirimtare, meqë përreth dy muaj Vegjëlina çlirimtare e Kosovës ia kishte dalë të ngrinte krye në përmasa eksplozive, duke u vetorganizuar në një UÇK, tashmë më famëmadhe se sa e kishte potencialin real. Ai sukses e kishte alarmuar Beogradit, prandaj është simuluar takimi...

Sigurisht, ushtaraku me kualifikime e përvojë të madhe, koloneli Ahmet Krasniqi, e dinte se si duhej organizuar lufta diversioniste kundër një ushtrie guerile çlirimtare, prandaj e ka filluar me vrull të sforcuar organizimin pas “marrëveshjes në Oslo”. Mjetet e bollshme financiare nuk i mungonin, meqë e kishte donator “kryeministrin” Bujar Bukoshi, me fondin e tij voluminoz, të cilin e menaxhonte sipas tekeve të tij, më saktësisht: sipas urdhrave të eprorëve të tij). Interesant, në këtë (dez)informatë të JB është emri i zëvendës komandantit për logjistikë të FARK-ut, Ibrahim Ukëhaxha, por qëllimisht është anashkaluar emri i komandantit Xhafer Jashari. Duhet ta ketë anashkaluar Agim Mehmeti, Zëvendësi i Ahmet Krasniqit, në memoaret e të cilit bazohet JB, siç ka ofruar fusnotën, ose e ka anashkaluar JB. [Ata që kanë lexuar librin e Agim Mehmetit mund të përgjigjen.] Meqë isha “brenda” ngjarjeve, më ngjan që Xhafer Jashari është anashkaluar pa u përmend, sepse Agim Mehmeti dhe JB në ndërkohë janë informuar se ai ishte kuadër i UÇK-së dhe ishte atje i dërguar nga UÇK-ja, bashkë edhe me 4-5 kolegë e shokë të tij [Fadil Demiri, Agim Haziri, Ramadan e Binak Gashi], dhe ishin infiltruar pranë Ahmet Krasniqit që ta pengonin të mos bënte veprimtari diversioniste, e nëse nuk do të mund ta pengonin, të paktën të kishim informacion. Dhe vërtetë, Ahmet

Krasniqi shpejt e përgatiti “brigadën” (nr. 134), me rreth 150 pjesëtarë, të cilën e urdhëroi të futej në Kosovë me 24 qershor 1998, nën komandën e ushtarakut Tahir Zemaj. Për këtë, vetë JB (dez)informon: *“Më 20 qershor 1998 në Viçidol e Papaj, nga ana e kolonel Ahmet Krasniqit dhe stafit komandues u bë intervistimi i brigadave 131, 133 dhe 134 me ç’rast, të nesërmen, u dha betimi ushtarak. Me këtë rast, kolonel Krasniqi dha urdhër që brigadat e caktuara të futen në Kosovë (në rajonin Gjocaj-Jasiq) brenda 48 orësh. Përgjegjës i këtij veprimi historik u caktua kolonel Tahir Zemaj.”*¹⁹

Ndërsa për ndodhjen e diversionit në terren, sipas “marrëveshjes në Oslo”, JB (dez)informon:

*“Në ndërkohë, pra nga maji deri në fund të gushtit 1998, njësitë e FARK-ut e të UÇK-së vepronin në përputhje me konceptin e luftës së përbashkët. Mbi këtë koncept ishte edhe formimi i Zonës së Tretë Operative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me ç’rast njësitë luftarake të kësaj Zone do të komandohen nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës.”*²⁰

Hutinë për “marrëveshje në Oslo” e shton edhe kundërvënia e Shtabit të Përgjithshëm. Për këtë JB (dez)informon:

“Por, Shtabi i Zonës së Tretë Operative të Rrafshit të Dukagjinit nuk pati jetë të gjatë. Në këto rrethana doli në skenë Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me drejtuesit e

¹⁹ Teksti i Betimit ushtarak, i dekretuar nga Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës si dhe Forcat e Armatosura: “Unë, ushtar i popullit BETOHEM në emër të ATDHEUT dhe KUSHTETUTËS, përpara ZOTIT dhe FLAMURIT kombëtar, se do të jem besnik dhe i pakursyer në luftën për çlirimin e Kosovës, kundër pushtuesit dhe tradhtarëve të vendit, deri në pikën e fundit të gjakut tim. Do të jem ushtar i bindur dhe i disiplinuar, dhe do të zbatoj me korrektësi urdhrat dhe detyrat e komandave eprore që lidhen me luftën çlirimtare, ushtrinë dhe sekretin ushtarak. BETOHEM!”

²⁰ Zona e Tretë Operative e UÇK-së u formua më 04.07.1998. Ndërsa Shtabi i Zonës së Tretë Operative të Rrafshit të Dukagjinit u krijua më 20-21 gusht 1998. Shtabi i saj u formua nga oficerët e njësisë operative të UÇK-së, brigadave 131, 133 dhe 134 dhe të njësisë të komanduara nga Ramush Haradinaj. Tahir Zemaj u caktua komandant i shtabit, ndërsa Ramush Haradinaj u caktua zëvendëskomandant. Kryeshef i Shtabit Operativ u caktua Nazif Ramabaja, ndërsa ndihmës komandant për sigurim u caktua Idriz Elezaj. (Shih: Ahmetaj, Arbër-Krasniqi Sefedin: “Kështu foli Tahir Zemaj”, 2001, faqe 80-83.)

saj politikë: Hashim Thaçi, Rexhep Selimi, Bislim Zyrapi e të tjerë, të cilët nuk e pranuan shtabin e përbashkët, me arsyetimin se Ramush Haradinaj duhej të ishte Komandant i Zonës së Tretë Operative në vend të Tahir Zemajt. (...) Kjo ndërhyrje, edhe pse në Dukagjin nuk mund të kishte pasojë të drejtpërdrejta, ngaqë ishte ofensiva e ushtrisë serbe në atë pjesë, e cila gjatë gushtit dhe shtatorit forcat e përbashkëta ushtarake i sollin para disfatës me ç'rast, për t'u mbrojtur popullata nga masakrat serbe, shpëtimi u kërkua nga tërheqja në Shqipëri e të gjitha njësitë, pasi që paraprakisht forcave serbe t'u jetë dorëzuar një kontingjent i madh armësh, megjithatë ajo ua hapi udhën e rrënimit të atyre që ishin arritur në përputhje me marrëveshjen e Oslos, të cilat përfundimisht u zhvlerësuan pas vrasjes së kolonel Ahmet Krasniqit në Tiranë.”²¹

Ec e merr vesh këtë kakofoni! Në një rën anë në Oslo paskëshin bërë marrëveshje për bashkim, në anën tjetër, në terren, kundërshtohet ai bashkim! Përse?

Nënkapitullin përmbyllës të kapitullit që po e shqyrtoj, JB e ka quajtur: “LPK merr primatin e luftës në terren”.

Për ata që kanë qenë në rrjedhë të ngjarjes, në Kosovë nuk ka pasur fare ndonjë garë për primat të luftës, meqë e gjithë “alternativa kosovare” (partitë “legale”, “qeveria”, Kuvendi, në ndërkohë jo funksional, dhe subjektet tjera, që pushteti serb i toleronte të

²¹ Kolonel Ahmet Krasniqi u vra në Tiranë më 21 shtator 1998 në orët e natës, kur po kthehej nga një takim që kishte me disa nga ushtarakët, me të cilët po shqyrtohehin përgatitjet për futjen e tri brigadave të tjera në Kosovë, të cilat do të inkuadroheshin në luftë kundër forcave serbe në Dukagjin si dhe për kalimin e një pjese të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Mbrojtëse të Republikës së Kosovës në pjesën e kufirit në mënyrë, që prej andej të drejtohej lufta në Kosovë. Persona të maskuar, kishin ndalur veturën në të cilën ndodhej kolonel Krasniqi dhe pasi që ai ishte nxjerrë jashtë, kishin hedhur breshëri plumbash mbi të. Qeveria shqiptare, jo vetëm që nuk e kishte marrë në mbrojtje kolonel Krasniqin, por, me veprimet e bëra kohëve të fundit (bastisjet e shtabit të Ministrisë së Mbrojtjes, çarmatosja e truporjave të kolonel Krasniqit dhe masat e tjera me të cilat atyre u rrezikohet siguria), kishte përgatitur terrenin, që atentatorët të mos hasin në kurrfarë vështirësish gjatë kryerjes së vrasjes. Të kësaj natyre ishin edhe hetimet shkel e shko të shtetit shqiptar, të zvarritura për vite, që nuk dhanë kurrfarë rezultati. Pas vrasjes së Kolonel Ahmet Krasniqit, kryeministri Bujar Bukoshi, caktoi kolonel Halil Bicajn në këtë post, me çka, praktikisht, FARK-u, jo vetëm që u marginalizua nga ana e UÇK-së, por u kthye edhe në palë kundërshtare me pasojë të rënda për luftën dhe për paqen. [Edhe kjo fusnotë, si të gjitha, janë nga JB.]

simulonin veprimtari patriotike), kishin përcaktim “pacifist”, ishin kundër dhunës, kundër luftës së armatosur çlirimtare, po se po. Ishte e vetmja Lëvizja, e cila qysh kur ishte themeluar (më 17 janar 1982), e cila ishte e përcaktuar për veprimtari aktive, çlirimtare, për të realizuar programin e saj politik: deri në vitin 1991 realizimin e barazimit të Kosovës me republikat tjera në RSFJ, nga viti 1991 e këtej, për çlirimin e Republikës së Kosovës, edhe me luftë të armatosur çlirimtare, nëse varianti pa përdorimin e dhunës nuk jep rezultat. Simulimet “institucionaliste” të viteve 1991-1993 ishin përcaktime të “alternativës kosovare”, që e komandonte “pacifisti” Ibrahim Rugova! Këtë JB e di, por tashmë simulon studiuesin, për të plasuar të pavërteta, respektivisht për të kamufluar komandimin e saj nga Beogradi, dhe e zbatonin marionetat e tij, si vetë ky JB, deri te Xhavit Haliti, Azem Syla e Hashim Thaçi.

JB (dez)informon: “Kështu, linja institucionale, jo vetëm që i humbi pozitat që kishte në organizimin dhe drejtimin e rezistencës së armatosur, por ajo u kthye në një marionetë për luftën e ashpër për pushtet që zhvillohej në LPK midis rrymave të Xhavit Halitit (fraksioni i Zvicrës) dhe të Ibrahim Kelmendit (fraksionit të Gjermanisë të njohur si enverist-stalinist) rreth primatit të luftës.”

Me keqardhje, JB e ka diskredituar vulgarisht profesionin e tij si historian (ai ka magjistruar në histori), meqë ka (sh)përdorur këtë rast për të plasuar dezinformim, por tashmë në shërbim të hakmarrjes personale.

E vërtetë është që unë kam bërë një “faj” ndaj JB: kam dekonspiruar një informim patriotik e njerëzor, që pati bërë Shefqet Hashani në tetor 1979, duke qenë në panair të librit në Frankfurt. Shefqeti atëherë ishte sekretar i parë në ambasadën jugo-sllave në Gjermaninë Perëndimore, që do të thotë përgjegjësi kryesor i SDB-së (Sigurimit Shtetëror Jugosllav) për veprimtari spiunazhi në Gjermani. Me atë rast Z. Hashani më pati këshilluar: “Ibrahim, të keni kujdes çka flisni e bëni në prani të Jusufit (Buxhovit), sepse ky është i detyruar të më informojë mua e unë jam i detyruar t’i përcjell në Beograd.” (parafrazim). Jusuf Buxhovi ishte i pranishëm. U përmbajt

të mos shfaqte hidhërimin, ndoshta nga se i frikësohej eprorit të tij, Shefqetit. Por, unë e relaksova ate, duke e vlerësuar atë informim si shaka rasti, sepse po më vinte keq për të; kisha konsideratë për përgatitjen e tij intelektuale, poliedrike. Atë këshillë të Shefqet Hashanit e kam bërë publike vetëm pasi JB u bë komplotisti kryesor i rebelimit masiv në Kosovë, në dhjetor të vitit 1989, përmes “themelimit” të LDK-së.

Duhet të jesh usta i luftës speciale, si JB, që të sajosh këtë gjetje: *“Kështu, linja institucionale, jo vetëm që humbi pozitën që kishte në organizimin dhe drejtimin e rezistencës së armatosur...”* Pra, qëllimi është për ta plasuar falsifikimin, sikur “linja institucionale”, e themeluar nga JB dhe e komanduar nga Ibrahim Rugova, e kishte në dorë të saj deri atëherë *“organizimin dhe drejtimin e rezistencës së armatosur”*, por ja që tani i “humbi pozitën”. Dhe ky lloj falsifikimi bëhet edhe më i besueshëm, duke ia shtuar “pikanterinë” vijuese: *“ajo [“linja institucionale” – shën. imi I.K.] u kthye në një marionetë për luftën e ashpër për pushtet që zhvillohej në LPK midis rrymave të Xhavit Halitit (fraksioni i Zvicrës) dhe të Ibrahim Kelmendit (fraksionit të Gjermanisë të njohur si enverist-stalinist) rreth primatit të luftës.”* Përse ka dezinformuar kaq trashë JB? Të gjithë bashkëveprimtarët e afërt, ata që ishin në udhëheqje të Lëvizjes (Këshilli i përgjithshëm, Kryesia, Redaksia e “Zërit të Kosovës”), ku ishte anëtar edhe Xhavit Haliti, e dinë se Xhaviti ishte publikisht, me foddullëk të fryrë vetë-reklamues “enverist-stalinist”, ndërsa unë, nga viti 1979 jam përmbajtur që të mos e shfaq publikisht një përcaktim të tillë ideopolitik. Kjo jo për shkak të ndonjë konvertimi, por kryesisht si pasojë e kritikës dhe këshillës që ma patën bërë në dhjetor 1978 “diplomatët” shqiptarë, Simon Qirici dhe Sazan Beu, të cilët ishin kuadrot kryesore në Ambasadën e Shqipërisë në Vjenë. Ata patën ardhur në një vizitë të pa paralajmëruar në Bochum (atëherë banoja në konvikt të studentëve atje) dhe ma tundën pamfletin “Bashkimi”, duke më kritikuar për propagandimin afirmativ të Enver Hoxhës dhe marksizëm-leninizmit dhe duke këshilluar që të mos shfaqnim më publikisht simpati për EH dhe ideologjinë m-l, por të merreshim

vetëm me kërkesa për barazi nacionale në kuadër të Jugosllavisë. Në fakt, në atë takim të parë u keqkuptuam dhe u grindëm, meqë nuk prisja që diplomatë të Shqipërisë të shfaqnin një qëndrim të tillë. Por, në takime të tjera ia dolën të më bindnin për atë përcaktim, se ishte racional. Mëpastaj u pendova shumë që ia kishte dalë Xhevat Ramabaja të më bindte ta themelonim Frontin e Kuq Popullor, meqë edhe Simoni e Sazani më patën bindur se ishte emërtim keq-ndikues për kauzën e shqiptarëve në Jugosllavi, në rrethanat e atëhershme politike, kur kihet parasysh fakti se RSFJ kishte përkrahje të madhe politike dhe ekonomike e ushtarake nga Lindja dhe Perëndimi. Meqë tashmë, gjatë vitit 1997-98 e kishim përvijuar atë platformë enveriste, marksiste-leniniste, ishte e zorshme ta përcillja menjëherë një këshillë të tillë të bashkëveprimtarët, meqë na ishte imponuar një lloj diferencimi i madh: patriotët janë enveristë, tradhtarët janë titistë. Në këtë vazhdë herë pas here pata keqkuptime edhe me Jusuf Gërvallën, i cili ishte "enveristi" më fundamentalist e fanatik. Fatkeqësisht, Jusuf Gërvalla i ka shkruar një raportim konspirativ Sabri Novosellës, për të cilin jam informuar për herë të parë në fund të vitit 2014. Originali titullohet:

"Raport për degën Hasan Prishtina, 31 korrik 1981

Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës dhe Viseve të tjera Shqiptare - Komitetit të Degës "Hasan Prishtina"

RAPORT

mbi disa çështje rreth punës së organizatave Grupi komunist "Zëri i Kosovës" dhe Fronti i Kuq Popullor."

Po sjell këtu ca fragmente nga ky raport, që vërtetojnë keqkuptimet ideo-politike që i kishim atëherë.

Jusuf Gërvalla:

"Që të mos zgjatem me detaje, ja vrojtimet e mia në pika të shkurtra lidhur me veprimtarinë dhe personalitetin e I. Kelmendit. Kurdoherë ka anuar nga aksione të natyrës terroriste dhe në këtë drejtim i ka nxitur edhe shokët e vet. Unë ia kam tërhequr vërejtjen se kjo gjë është e dënueshme edhe nga pikëpamja e PPSH. (...) Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe

negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. (...) (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena, lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori*, në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.) Ka pasur vërejtje rreth Kushtetutës së RPSSH dhe rreth përgatitjes "luksoze" të librave të shokut Enver në "dëm" të botimeve letrare të RPSSH! Vërejtjen e parë na e ka thënë haptazi mua dhe shokëve të Vjenës, të dytën vetëm mua. Arsyetohet se ka të drejtë të bëjë vërejtje gjithfare dhe këto dilema të tij nuk i paraqet te masat, por i diskuton vetëm me shokë. Unë s'mund ta di a është e saktë kjo. Përkundër bindjeve të mia se është e panevojshme dhe e pamirë një gjë e tillë, jam detyruar të udhëtoj me qindra kilometra për ta "arsyetuar" te shokët e tij artikullin e përmendur. Ai më ka propozuar pastaj me këmbëngulje që këtë gjë ta përsëris edhe me shkrim në artikullin e "Bashkimit" me titull "Zëri i Popullit - zë i të gjithë shqiptarëve" (këtë numër s'e keni pasur prandaj po jua dërgoj). (Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë". Kështu kam vepruar nga gushti 1980, deri në fillim të vitit 1981, kur më ka ardhur në derë me disa materiale të çoroditura për numrin e ri të "Bashkimit". (...) Përndryshe, një meritë të tij, mendoj, nuk mund ta përbuzë askush: që nga viti 1977 e këtej, i vetëm, po me një vitalitet të pashoq, ka bërë shumë në shpërndarjen e literaturës revolucionare, si ka mundur e si ka ditur, dhe në njëfarë politizimi spontan të një pjese të mirë të punëtorëve tanë në botën e jashtme. Është njeri komunikativ dhe i popullarizuar te punëtorët. Udhëton shumë, vlon prej idesh, shpesh naive e të papërpunuara, ndonjëherë edhe të qëlluara.

SOKOLI²²

* „Profesori“ ishte nofka konspirative për Bujar Hoxhën (Djalin e Hoxhë Kadrisë), „diplomat“ i Shqipërisë në Turqi dhe kuadër i Sigurimit...

²² E ka publikuar për herë të parë Faridin Tafallari, më 2 tetor 2011, në www.albaniapress.com

Ky raportim që Jusuf Gërvalla ia ka dërguar udhëheqësit të tij, Sabri Novosellës, është një dëshmi fatkeqe, për këtë lloj lajthitjeje të tij, siç kanë lajthitje pothuajse të gjithë veprimtarët e zellshëm të kauzës kombëtare. E solla vetëm si një dëshmi, që diskualifikon dezinformimin e JB dhe jo për t'i bërë ndonjë koment, meqë nuk përkon me reagimin që po shkruaj kundër një kapitulli të “Kosovës” së JB.

Jam i vetmi në Lëvizje që duhet të jetë dënuar (me shkrim) me parapërrjashtim nga redaksia e “Zërit të Kosovës” (në vitin 1987; atëherë ishte kryeredaktor Mustafë Xhemajli), vetëm pse pata kritikuar redaksinë për botim të një shkrimi propagandistik për EH, duke e ven në faqe të parë portretin e madh të EH. Ndërsa Xhavit Haliti përherë ka vazhduar të (vetë)reklamohet me pompozitet si “enverist”, pa qenë fare, por vetëm pse kishte një rol të tillë – për ta komplotuar Lëvizjen...

JB duhet të ketë dëgjuar muhabete kafehanesh për përplasjet që kishim unë dhe Xhaviti, të cilat datojnë qysh nga janari i vitit 1991, kur kam veneruar komplotet e Xhavitit në Tiranë, në bashkëveprim me Hajdinë Sejdinë...

Ndërsa nga viti 1996 tematikë e konfliktit kanë qenë sabotimet që Xhaviti ia bënte UÇK-së. Por, asnjëherë nuk kemi pasur konflikt në mes të nëndegëve të Zvicrës dhe Gjermanisë. Xhaviti i ka komplotuar kryesisht bashkëpunëtorët e tij më të ngushtë, anëtarët e Kryesisë së Lëvizjes deri në maj 1998, të gjithë me banim në Zvicër (vetëm Muhamet Kelmendi, nënkryetar, jetonte në Gjermani). Dhe, ja kështu, përvijohen dezinformatat, për t'u konvertuar në të vërteta, përmes propagandimit dhe fuqisë financiare që i qëndron mbrapa, siç është rasti me këto “vepra” të politizuara të JB! Fatkeqësisht, JB ka (sh)përdoruar edhe një libër të Muhamet Kelmendit²³, gjoja si burim autentik, siç ka informuar në fusnotë...

²³ Më gjerësisht shih: Kelmendi, Muhamet: “Pse nuk u ndërtua Froni për çlirimin e Kosovës”, Prishtinë; siç po shihet, këtu JB nuk ka përmend numër faqes të librit të Muhametit, që të verifikohet (dez)informimi i tij, që e citova dhe e komentova.

Në vazhdim JB ka akuzuar edhe qeverinë e Tiranës, sikur ajo paskësh ndihmuar Xhavit Halitin e Hashim Thaçin, për të bërë “puç të hapur ushtarak kundër linjës institucionale”, por mua me rezulton të jetë dezinformatë. Deri sa ishte Fatos Nano kryeministër (14 shtator 1998), angazhimi i ca segmenteve të qeverisë se tij ishte kundër UÇK-së (pro “Shtabit të Rognerit”), dhe jo kundër FARK-ut, meqë komandantet e “shtabit të rognerit” bashkëpunonin e koordinonin komplotin në bashkëveprim me Ahmet Krasniqin, kundër UÇK-së. Fatkeqësisht!

Mëpastaj JB plason edhe (dez)informatën vijuese: *“Pas vrasjes së kolonel Ahmet Krasniqit në Tiranë, Qeveria e Bukoshit u mundua të ruajë ‘kursin e luftës’ – duke bërë përpjekje që me ndihmën e parasë së shumtë që e dispononte, por edhe të ‘autoritetit gjerman’ të fitojë ndikim të brendshëm në strukturat rivalizuese të UÇK-së – detyrimisht iu nënshtrua plotësisht rrethanave, që dominoheshin nga SHP i UÇK-së i drejtuar nga H. Thaçi dhe Xh. Haliti, të cilët tashmë kishin fituar luftën e brendshme për pushtet në LPK në raport me grupin e Dyseldorfit (të I. Kelmendit), gjë që kjo ishte një disfatë e dyfishtë e linjës institucionale ndaj asaj jashtë-institucionale.”*

Për keqardhje kjo katandisje kaq mjerane e JB! Nuk me besohet të ketë qenë kaq i painformuar lidhur me “luftën” e brendshme në Lëvizje. Në Kuvendin e përgjithshëm të Lëvizjes, i mbajtur në fillim të majit 1998, nuk kanë marrë vota të mjaftueshme për të qenë anëtar në kryesi të Lëvizjes as Xhavit Haliti, as Azem Sylja, as Hashim Thaçi. Ndërsa, - ndoshta edhe për inat të JB, - jam votuar unë për të qenë anëtar në Kryesi. Por, këtë askush në Lëvizje nuk e kemi komentuar si fitore e “krahut” tim, kundër “krahut” të Xhavit Halitit.

Befasues për mua është një spekulim që JB e ka “përvjedhur” si fusnotë:

“Kur flitet ‘për autoritetin gjerman’ të Bukoshit, kihet parasysh ‘rezidimi’ i tij në Gjermani me tretmanin e ‘veprimtarit politik’ që ai e gëzonte si Kryeministër i Qeverisë së Kosovës dhe madje në forma të ndryshme, u ndihmua dhe u mbajt nën mbikëqyrje në përputhje me

logjikën e politikës pa luftë dhe të luftës pa politikë. Nga shumë burime bëhet e ditur se nga viti 1996, sektorë të caktuara të Shërbimit Informativ Gjerman (BND) si dhe atij ushtarak (MAD) kanë marrë pjesë në ushtrimin e grupeve të UÇK-së dhe të përgatitjes së tyre për rezistencë të armatosur. “How Germany backe KLA”, thuhej në një shkrim të gazetës “The European” të 21 shtatorit 1998, ku shihet se diplomacia gjermane në mënyrë diskrete po përkrah UÇK-në. Autori Roger Fallgot këtë përkrahje e lidh me emërimin e Hansjoerg Geiger shef të BND-së në vitin 1996, i cili si prioritet kishte caktuar krijimin e një shërbimi gjerman në Shqipëri që do të merrej me ushtrimin e UÇK-së. Thuhet se në Tiranë, Geiger dërgoi disa oficerë nga radhët e forcave speciale të Bundesverit (KSK), të cilët morën pjesë në trajnimin e rebelëve shqiptarë. Përfshirjen e shërbimit informativ gjerman BND në pjesët e ish Jugosllavisë (Kroaci dhe Kosovë) e vërteton edhe Erich Schmid-Enboom në librin “Der Schattenkring: Klaus Kinkel und fer NBD”, Dyseldof. Për publicistin e njohur gjerman Boris Kalnok, Bujar Bukoshi ishte “shef i njëmendët i UÇK-së”, që jo vetëm për nga financat që derdhte për grupet e caktuara, po edhe për nga përpjekjet që bënte politikisht ta drejtojë nga prapa. (Shih: “Die Welt”, 15 korrik 1998). Në kuadër të këtyre njoftimeve, vëmendje të posaçme meritojnë ato në të cilat thuhet se BND vazhdimisht e ka pasur pranë Bukoshin dhe e ka përkrahur në përputhje me interesat gjermane, siç është përkrahur edhe ‘linja gjermane’ e LPK-së, me të cilët thuhet se Bukoshi ka qenë i udhëzuar të bashkëpunojë vazhdimisht. Me këtë rast thuhet se BND gjermane, nga mesi i vitit 1998 e këndeje, ka vepruar konkretisht që nëpërmes Bukoshit, ‘linja gjermane’ e LPK-së, të luftojë që ajo të fitojë primatin në kuadër të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, që të mos dominohej nga ‘linja franceze’ (Hashim Thaçi). Disa burime gjermane bëjnë të ditur se rivaliteti midis shërbimit informativ gjerman BND dhe atij francez për dominimin e kreut të UÇK-së, kishte përfunduar me ‘një kompromis’, të imponuar nga amerikanët dhe britanikët, të cilët gjeneral A. Çekun e kishin emëruar komandant të UÇK-së... (Më gjerësisht shih: Küntzel, Matthias*: “Der Weg in den Krieg”, Berlin,

* Autori Matthias Küntzel qenka mësues për politikë në një shkollë të mesme për kualifikime zanatesh në Hamburg; këtë informacion e ka në

2000; Binder, David: „Wo schon vier Großmächte sich di Finger verbrannten“, in: „Blätter für deutsche und internationale Politik“, April 1999, faqe 424).”

Vërtetë për keqardhje, se si JB, në frymën e një lufte speciale që e ka kokën në Beograd, ka përzgjedhur (dez)informata e opinione të gjermanëve serbofilë, për të ofruar shpifje kaq ordinere, në një “vepër” me pretendimin për të qenë enciklopedike! Asgjë prej gjëje nuk me rezulton të jetë e vërtetë në këto që i mvishen qeverisë dhe institucioneve të tjera gjermane! Por “veprat” duhet të mbushen disi, sepse mundet që ka kontratë të paguhet për faqe dhe jo për cilësi. [Asnjë pjesëmarrës i UÇK-së nuk dëshmon dot të jeto stërvitur nga ushtarakët e Ushtrisë Gjermane ose oficerët e BND-së!]

Këtë kapitull JB e përmyll me vajtimin:

“Kjo disfatë, megjithatë, do të mundë të evitohej vetëm po qe se dr. Ibrahim Rugova, në përputhje me Kushtetutën e Kaçanikut, do të merrte përsipër përgjegjësinë e luftës si dhe drejtimin e saj si komandant i përgjithshëm i forcave të armatosura të Republikës së Kosovës.”

Por ja që “presidenti” IR nuk ishte i përgjegjshëm për përgjegjësitë që i takonin. Arsyet pse IR ka mbajtur atë qëndrim mund t’i ketë shtjelluar JB në kapitullin vijues. Ndoshta?

web-faqen e tij personale.

<http://www.matthiaskuentzel.de/contents/ueber-den-autor>